ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër**: SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**GRA618-24-2346-1-2-1**
Nr i brendshëm	**GRA618-24-003-121**

Sa i përket tenderit për: "Furnizimi i barnave".

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

"MEDPLUS SH.P.K."

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lebanë, Rr. Pranvera e Lirisë,p.n

(Adresa)

Prishtinë *10000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38344640420 *N/A*

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

17.04.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. MEDPLUS Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 14.03.2024 Hapja e ofertave 03.04.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt.05.04.2024 Kërkesa për rishqyrtim: 11.04.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 12.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 70 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt. 05.04.2024 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE**N.SH.T. "NERAMED",** ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Tek neni 3.1 - Specifikacionet teknike të detyrueshme, tek dosja e tenderit është specifikuar qartë si në vijim***: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:***
a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertën e tij nuk ka prezantuar deklaratën për specifikime teknike, ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit.

Kur kemi parasysh faktin se kërkesat e dosjes së tenderit janë kërkesa obligative për të gjithë OE pjesëmarrës dhe të njëjtat duhet të plotësohen nga të gjithë operatorët ekonomik, atëherë OE i rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e autoritetit kontraktues.

Përderisa nuk është ofruar deklarata e lartcekur nga OE i rekomanduar për kontratë, atëherë i njëjti nuk mund dhe nuk është dashur në asnjë mënyrë të rekomandohet për kontratë, mirëpo AK-ja është dashur ta eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit.

Me dt.12.04.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja me arsyetimin se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.
Arsyetimi i dhënë nga AK-së në lidhje me deklaratën për specifikime teknike është dhënë si në vijim:

> Sa i përket Nenit 3.1 Autoriteti Kontraktues - Komuna e Graçanicës konsideron se ai mbulohet nga Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM;

Arsyetimi i AK-së është arsyetim absurd kur konstaton se deklarata nën betim e mbulon deklaratën për specifikime teknike.
Deklarata për specifikime teknike parashihet në nenin 3.1 të dosjes së FDT-së dhe ka për qëllim që OE të garantojë se produktet e ofruara do të jenë në harmoni me specifikimet teknike të detyrueshme, kurse në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar këtë deklaratë dhe nëse ndodh eventualisht që gjatë implementimit të kontratës të mos ofrohen produktet sipas specifikimeve teknike, atëherë nuk mundet të detyrohet i njëjti OE që të bëjë furnizimin sipas specifikimeve teknike të detyrueshme.
Kërkesa për përputhshmëri të specifikimeve teknike është kërkesë obligative dhe detyrimisht duhet të plotësohet për tu konsideruar i përgjegjshëm operatori ekonomik.
Deklarata nën betim është deklaratë e cila nënshkruhet dhe vuloset nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik, e ku merret përgjegjësia për përshtatshmëri profesionale sipas nenit 65 të LPP-së dhe pranohet që të sanksionohet nëse nuk përmbushen këto kërkesa sipas nenit 65 të LPP-së.
Pra, deklarata nën betim, nuk ka të bëjë fare me deklaratën për përputhshmëri të specifikimeve teknike, prandaj në këtë rast përgjigja e AK-së është shumë jo profesionale dhe e pa arsyetuar me ndonjë argument apo me ndonjë dispozitë të LPP-së.
Po ashtu edhe përmendja në vendim e listës së kontratave, licencës nga AKPM, certifikatës ISO 9001:2015 nuk kanë të bëjnë fare me deklaratën për përputhshmëri të specifikimeve teknike, por AK-së është munduar të bëjë arsyetime në kundërshtim me faktet dhe argumentet e dëshmive të lëndës.
Nga të gjitha sqarimet dhe dëshmitë që u cekën, vërtetohet saktë se vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe subjektiv.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse ne jemi operator ekonomik i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos u rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e OE **MEDPLUS SH.P.K**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*